VENDIM
Nr. 12, datë 1.4.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 69, pika 6 të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre"; dhe të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 104, datë 5.10.2016, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 4, pas pikës 2, shtohet pika 3, me përmbajtjen mëposhtme:

"3. Për qëllime të kësaj rregulloreje, person me "reputacion të mirë" konsiderohet anëtari, donatori, administratori dhe anëtari i organit drejtues të SHKK-së ose të Unionit, i cili karakterizohet nga etika profesionale dhe integriteti moral dhe financiar, si dhe përputhshmëria me kuadrin ligjor e rregullativ. Një anëtar, donator, administrator apo anëtar i organit drejtues do të konsiderohet të ketë reputacion të mirë, nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

- nuk është i akuzuar në një proces penal;

- nuk është i dënuar penalisht;

- nuk ka detyrime pasurore dhe tatimore të pashlyera;

- nuk është objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm; dhe

- nuk bën pjesë në listat e shpallura të sanksioneve ndërkombëtare.";

b) Në nenin 5, pika 9/1, togfjalëshi "*Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave*", zëvendësohet me togfjalëshin "*Agjencia e Inteligjencës Financiare*";

c) Në nenin 6, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 2, shkronja "f", pas nënpikës "iii", shtohet nënpika "iv" me përmbajtjen e mëposhtme:

"iv. vërtetimin ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i cili të jetë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë;";

ii. në pikën 2, shkronja "g", pas nënpikës "iii", shtohet nënpika "iv" me përmbajtjen e mëposhtme:

"iv. vërtetimin ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i cili të jetë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë;";

d) Në nenin 7, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në fund të pikës 3, shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:

"SHKK-ja ka të drejtë të riaplikojë për licencim, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.";

ii. në pikën 4/1, pas togfjalëshit *"për parandalimin e pastrimit të parave,"*, shtohet togfjalëshi *"Agjencia e Inteligjencës Financiare,";*

iii. pas pikës 4/1, shtohet pika 4/2 me përmbajtjen e mëposhtme:

"4/2. Banka e Shqipërisë, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kritereve të përshtatshmërisë dhe integritetit të anëtarëve themelues/donatorëve, administratorit dhe anëtarëve të organeve drejtuese, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe të Bashkimit Evropian (BE), njoftimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), si dhe listat e integruara të personave të shpallur.";

e) Në nenin 8, pika 1/1, shkronja "b", pas nënpikës "iv", shtohen nënpikat "v" dhe "vi", me përmbajtjet e mëposhtme:

" v. nuk ka reputacion të mirë;

vi. ka qenë pjesë e strukturës së pronësisë së një institucioni financiar, ndaj të cilit është vendosur masa e revokimit të licencës nga Banka e Shqipërisë ose nga një autoritet tjetër mbikëqyrës.";

f) Në nenin 12, pas pikës 6, shtohet pika 7 me përmbajtjen e mëposhtme:

"7. SHKK-ja ndaj së cilës është vendosur masa e revokimit të licencës nga Banka e Shqipërisë, nuk mund të aplikojë sërish për licencim.";

g) Në nenin 14, pika 1, pas shkronjës "h", shtohet shkronja "i" me përmbajtjen e mëposhtme:

"i) vërtetim ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent nga organet kompetente të shtetit të huaj, të lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.";

h) Në nenin 16, në fund të pikës 3, shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:

"SHKK-ja ka të drejtë të kërkojë rifillimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratimin paraprak, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.";

i) Në nenin 18, pas pikës 2, shtohen pikat 3 dhe 4 me përmbajtjet e mëposhtme:

"3. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur për njoftimet e parashikuara në këtë nen, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar nuk plotësohet nga SHKK-ja brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së paraqitjes së këtij njoftimi. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të dokumentacionit, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim SHKK-në. SHKK-ja ka të drejtë të kërkojë rifillimin e procedurës së shqyrtimit të njoftimit, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.

4. Banka e Shqipërisë, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse e vlerëson të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.";

j) Në nenin 22, në fund të pikës 4, shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:

"Subjekti ka të drejtë të kërkojë rifillimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratimin paraprak, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.";

k) Në nenin 24, pika 2, pas shkronjës "h", shtohet shkronja "i" me përmbajtjen e mëposhtme:

“i) vërtetim ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent nga organet kompetente të shtetit të huaj, të lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.”;

l) Në formularin nr. 6 (aneksi i rregullores), pas pikës 4, shtohet pika 5 me përmbajtjen e mëposhtme:

“5. Informacion mbi hapësira/mjedise të veçanta të nevojshme, si dhe kushte të përshtatshme për evidentimin, mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit lidhur me ushtrimin e veprimtarisë.”;

m) Në formularin nr. 10 (aneksi i rregullores), në fund të formularit shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:

“Shënim. Për qëllime të plotësimit të këtij formulari, lidhje familjare me një person do të konsiderohen të afërmit e ngushtë sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 10, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, ku përfshihen: a) fëmijët (ose të birësuarit); b) fëmijët e fëmijëve; c) bashkëshorti/ja; d) prindërit; e) vëllezërit, motrat, si dhe fëmijët e tyre; f) personat në kujdestarinë e tij.”;

n) Në formularin nr. 10/1 (aneksi i rregullores), në fund të formularit shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:

“Shënim. Për qëllime të plotësimit të këtij formulari, lidhje familjare me një person do të konsiderohen të afërmit e ngushtë sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 10, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, ku përfshihen: a) fëmijët (ose të birësuarit); b) fëmijët e fëmijëve; c) bashkëshorti/ja; d) prindërit; e) vëllezërit, motrat, si dhe fëmijët e tyre; f) personat në kujdestarinë e tij.”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko